EKSPOZITË PERSONALE

BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KOSOVËS

THE NATIONAL AND UNIVERSITY LIBRARY OF KOSOVA

JAVA E BIBLIOTEKËS NË KOSOVËS

3 - 8 prill 2006

Botues:
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Drejtor:
Dr. Sali Bashota

Dizajni
Hekuran Rexhepi

© 2006, BKUK

Prishtinë
2006

REXHEP FERRI

Jo fort moti , ka ndoshta tri vite, në një shtëpi të vogël zjarrmi, të braktisur dhe të mbytur me erëra ngjyrash dhe rutubet qerpiçësh, si sot po vështroja pluhurat dhe vizatimet e Rexhep Ferrit. Kisha ndjenjën e të qëndruarit pran njeriut që siç do të thoshte i moçmi Lao Ce, lirohej nga epshet që të mund të shihte Fshehtësinë e Jetës, por i cili njëherazi me gjithë pasionin vështronte jetën që t'ia shihte format. Atëherë mu duk, dhe edhe tash ashtu mendoj, se te dy këto aspekte ishin dhe mbetën të pranishme në punimet e tij. Edhe diçka: ato pëlhura dhe ato vizatime ma bënin qarte se kisha të bëja me një koprrac finok dhe jo aq te vockël. Sepse aty nuk kishte shume ngjyra, si te disa pikturëprishës të tjerë, tek të cilët nuk kam arritur ta ndjej bukurinë e lojës vezulluese të frymës njerëzore.

Me dukej sikur çdo gjë ishte bërë në shenjën e yllit fatlum të kursimit: kishte aty vetëm aq gjera sa duheshin për të mbajtur distancën e pranueshme nga sipërfaqësorja, më saktësisht nga preciozja, ne thelb nga efemerja. Lëvizja ishte e pastër, e matur, e sigurt dhe e derdhur në një tërësi të ngjeshur, iluzorisht të ftohtë dhe të varfër, e në të vërtetë në një klaviaturë përplot bashkëtingëllime të begatshme. Ferri nuk vuan nga emfatikja, nga trumbetimi, nga thekimi i tepërt. Por në të njëjtën kohë ai nuk çan kokën fare për ato qëndisma që të ofrojnë të thatën për të freskët, të pajetën për të gjallë. I kultivuar në gurrat e traditës së popullit të tij dhe të popujve të tjerë, shihet qartë se më me dëshirë gjithnjë e kërkon vetëm thelbësoren. Prandaj kundrimi i tij i botës nuk është kundrim bredhacaku, po vrojtim i shtegtarit të zhytur thellë në mendime në trekëndëshin: dje, sot, nesër. Dhe çka sheh ai?

Mendoj se ne ato pëlhura dhe vizatime ai ka bërë një përpjekje të vlefshme për të fiksuar mbërthimet rrënimtare që e mundojnë njeriun në botën modeme. Edhe pse kjo është e dhimbshme, Rexhep Ferri kurrë nuk e ka "pikturuar" dhimbjen, po vetëm klizhmën e cila tërë pëlhurën apo vizatimin e shndërron në pikëpyetje, apo në thonjëza, në presje, apo në pikëçuditëse, por kurrë ne pike.

Anton PASHKU









REXHEP FERRI

1937 u lind ne Kukës (Shqipëri)
1958 mbaroi Shkollën e mesme të Artit në Pejë
1962 botoi poezitë nga cikli "Shëtitësit e lodhur" në revistën letrare 'Jeta e re" ne Prishtinë.
1966 u diplomua në Degën e Pikturës Monumentale në Akademinë e Arteve në Beograd
1967 hapi ekspozitën e pavarur në Galerinë e Qendrës Kulturore në Prishtinë
1968 hapi ekspozitën e pavarur në Galerinë Grafiki Kolektiv në Beograd
1969 hapi ekspozitën e pavarur në Galerinë Darte II Cenacolo në Vicenca (Itali)
1970 mbaroi studimet pasuniversitare në Akademinë e Arteve në Beograd
1971 merr çmimin e dhjetorit të Kuvendit të Kosovës
1972 merr pjesë në Bienalen Mediterane të Aleksandrisë në Egjipt
1973 hapi ekspozitën e pavarur në Galerinë Grafiki Kolektiv në Beograd
1974 u zgjodh pedagog i Akademisë së Arteve Figurative në Prishtinë
1975 merr çmimin e Sallonit Pranveror për pikturë të Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës.
1976 hapi ekspozitën e pavarur në Galerinë Kulturni Centar në Beograd
1977 hapi ekspozitën e pavarur në Galerinë "Lambert" në Paris (Francë)
1978 botoi librin me poezi "Punë gjaku", Rilindja, Prishitnë
1979 hapi ekspozitën e pavarur në Galerinë e Qendrës Kulturore në Novi Sad
1980 hapi ekspozitën e pavarur në Galerinë e Qendrës Kulturore në Nish
1981 botoi librin me poezi "Qafa e diellit", Rilindja Prishtinë
1982 hapi ekspozitën e pavarur në Galerinë e Arteve në Prishtinë
1983 hapi ekspozitën e pavarur në Galerinë e Arteve në Sarajevë
1984 botoi librin me poezi "Këmisha e bardhë",Rilindja, Prishtinë
1985 merr pjesë në ekspozitën "Arti Bashkëhor i Kosoves" në Galerine Breht në Muknih(Gjermani)
1988 botoi librin me poezi "Trekëndësh me detin" në Prishitnë
1989 hapi ekspozitën e pavarur në Galerinë e Vakko në Izmir, Ankara, Stamboll (Turqi)
1992 botoi librin me poezi "Në profil" Rilindja, Prishtinë
1995 hapi ekspozitën e pavarur në Galerinë Kulla e Balshajve në Ulqin
1996 zgjidhet anëtar me korrespondencë i Akademisë se Shkencave dhe Arteve të Kosovës
1997 merr shpërblimin "Penën e artë" për poezinë më të mirë të botuar në revistën "Fjala" gjatë dy mitingjeve të poezisë në Gjakovë
1997 hapi ekspozitën e pavarur në Galerinë Dodona në Prishtinë
1997 botoi librin me poezi "Ndoshta ishte dashuri", Rilindja, Prishtinë
1998 hapi ekspozitën e pavarur në Galerinë Vakko në Stamboll (Turqi)
1998 botoi romanin "Atdheu im torzo", Rilindja, Prishtinë
1999 hapi ekspozitën e pavarur në Galerinë Evropa në Pejë
2000 botoi romanin "Njeriu po kush tjetër", Rilindja, Prishtinë
2001 hapi ekspozitën e pavarur në Galerinë Kombëtare në Tiranë

REXHEP FERRI

1937 born in Kukës (Albania);
1958 completed Middle Art School in Peja;
1962 published poems from cycle "Tired Wanderers" in the litterary review 'Jeta e re";
1966 graduated in the Department of Monumental Painting in the Art Academy in Belgrade;
1967 opened his independent exhibition in the Gallery of Culture Centre in Prishtina;
1968 opened his independent exhibition in the Gallery Grafiki Kolektiv in Belgrade;
1969 opened his independent exhibition in the Galeria D'arte II Cenacolo in Vicenza (Italy);
1970 completed post-graduate studies in the Academy of Arts in Belgrade;
1971 gets the December Award of Kosova Assembly;
1972 participates in the Mediterranean Biennial of Alexandria in Egypt;
1973 opened his independent exhibition in the Gallery Grafiki Kolektiv in Belgrade;
1974 was appointed teacher at the Academy of Fine Arts in Prishtina;
1975 gets the Prize of Spring Salon for painting of the Fine Arts Artists of Kosova Association;
1976 opened his independent exhibition in the Gallery Kulturni Centar in Belgrade;
1977 opened his independent exhibition in the Gallery "Lambert" in Paris (France);
1978 published his book of poetry "Blood business'; Rilindja, Prishtina;
1979 opened his independent exhibition in the Gallery of Culture Centre in Novi Sad;
1980 opened his independent exhibition in the Gallerz of Culture in Nish;
1981 published his bosk of poetry "The Neck of Sun", Rilindja, Prishtina;
1982 opened his independent exhibition in the Art Gallery of Prishtinaj;
1983 openeed his indepedent exhibition in the Art Gallery of Sarajevo;
1984 published his book of poetry "The White Shirt", Rilindja, Prishtina;
1985 attends the exhibition "Contemporary Art of Kosova" in Brecht Gallery in Munich (Germany);
1988 published his book of poetry "Triangle with the Sea"; Rilindja, Prishtina;
1989 opened his independent exhibition in the Gallery Vakko in Izmir, Ankara, Istanbul (Turkey);
1992 published his book of poetry "The Neck of Sun"; "Rilindja, Prishtina;
1995 opened his independent exhibition in the Gallery Castle of Balshaj's in Ulqin;
1996 is appointed correspondent member of Academy of Sciences and Arts of Kosova;
1997 is awarded "Golden Pen" for the best poem published in the rewiew "Fjala" during two meetings of poetry in Gjakova;
1997 opened his independent exhibition in the Gallery Dodona in Prishtina;
1997 published his book of poetry "Perhaps it was love'; Rilindja, Prishtina;
1998 opened his independent exhibition in the Gallery Vakko, Istanbul (Turkey);
1998 published his novel "My Torso Fatherland'; Rilindja, Prishtina;
1999 opened his independent exhibition in the Gallery Evropa in Peja;
2(XX) published his novel "Man, who else"; Rilindja, Prishtina;
2001 opened his independent exhibition in the Gallery in Tirana.

REXHEP FERRI